

VENDIM
Nr. 152, datë 3.7.2018

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“RENERGY TRADING GROUP” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d” të ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e”, dhe nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike” të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.7.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “*Renergy Trading Group*” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 465, datë 22.6.2017, shoqëria “*Renergy Trading Group*” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e Tregtimit të Energjisë Elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “*Renergy Trading Group*” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, si më poshtë:

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3): plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike (neni 9 pika 4.8): plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- formati i aplikimit (neni 9, pika 1), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “*Renergy Trading Group*” sh.p.k. në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti